URDHËR
Nr. 321, datë 29.6.2021

PËR SHFUQIZIMIN E URDHRIT NR. 326, DATË 15.5.2020, "PËR KUFIZIMIN E AKTIVITETEVE SPORTIVE' TË NDRYSHUAR DHE LEJIMIN E KAMPIONATEVE SPORTIVE ME PREZENCË TË TIFOZËVE ME KAPACITETE TË REDUKTUARA DERI NË 30%

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, nenit 7, pika 4, germa "b", të ligjit nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të ndryshuar, nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, si dhe vendimit të Komitetit Teknik nr. 2435, datë 27.5.2021,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 326, datë 15.5.2020, "Për kufizimin e aktiviteteve sportive", të ndryshuar.
2. Lejohen kampionatet sportive me prezencë të tifozëve me kapacitete të reduktuara deri në 30% sipas protokollit të miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë, i fillon efektet më datë 1.7.2021 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu